



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.20.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË
KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Ejup Simnica dhe Anëtare Valbona Pllana, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	21
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	22
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	25
Shtojca IV: Letërkonfirmimi.....	28

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 20.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Si theksim të çështjes tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e pasurive nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtorin e Sekretariatit me stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Kryesuesit të Këshillit Prokurorial- auditimi 2016**

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e pasurive fikse nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Ato janë të regjistruara me vlerën blerëse duke mos kalkuluar zhvlerësimin. Si rezultat i kësaj, vlera neto e pasurive nën 1,000€ është e mbi vlerësuar për 92,403€.

Dobësitë e vazhdueshme në sistemin e-pasuria, tregojnë se kontrollet në menaxhimin e pasurive nuk janë në nivelin e duhur. Për mos funksionalitetin e këtij sistemi KPK-ja ka njoftuar zyrtarët e Ministrisë së Administratës Publike dhe të MF-së, mirëpo ky problem nuk është evituar ende.

Opinionin jonë nuk modifikohet për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i Përgjithshëm i Këshillit Prokurorial të Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

KPK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur, përveç faktit që duhet përmendur se nuk ka pas raportim të saktë të obligimeve të papaguara.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

1.3 Rekomandimet

Për çështjen e theksuar të baza për opinion, ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme për të përmirësuar gabimet e identifikuara në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, të ndërmerren veprimet për të zhvlerësuar pasurinë bazuar në normat përkatëse të tyre, si dhe për të adresuar problemet që në vazhdimësi po e përcjellin sistemin e-pasuria.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KPK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga KPK siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KPK në përgjithësi ka treguar Qeverisje të mirë në raport me obligimet statutores. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. KPK ka përpiluar listën e rreziqeve në identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut, për të identifikuar pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave. Kjo reflekton prezencë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe njohuri brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut.

Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Institucionit.

KPK ka dorëzuar pyetësin e vet-vlerësimit, për vitin 2016 në MF-NjQH, disa nga përgjigjet e dhëna në këtë pyetësor janë notuar me notë maksimale (3), mirëpo dëshmitë dhe konkluzionet nuk ekzistonin ose nuk ishin të plota si dhe mungonte dokumentacioni mbështetës i bazuar në vlera financiare. Si rrjedhojë KPK nuk ka qenë objektive gjatë plotësimit të vet-vlerësimit. Kjo mund të paraqet mungesë të plotë të informacionit për MF-në rreth funksionimit të sistemit të MFK-së.

Zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i jashtëm është në nivel të ulët. Po ashtu niveli i zbatimit të rekomandimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) ishte i ulët në 55%.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e KPK-së për vitin 2016, ka rezultuar me dhjetë (10) rekomandime kryesore. KPK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm një (1) rekomandim është zbatuar, katër (4) janë në proces, dhe pesë (5) nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraparak - Prioritet i lartë

E gjetura KPK ka hartuar me kohë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit 2015, mirëpo kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i rekomandimeve monitorohet formalisht.

Rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar ndërlidhen me procesin e pagesave (zotimi i mjeteve dhe urdhërblerja pas datës së faturës), vonesat në shlyerjen e obligimeve dhe raportimi jo i saktë i tyre, si dhe shpalosje jo e saktë e vlerës neto të pasurive me vlerë nën 1,000€.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave dhe shfrytëzimit të buxhetit.

Rekomandimi 2 Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë se është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar. Veprime shtesë të ndërmerren ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit të këtyre rekomandimeve.

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për KPK-në të cilat së bashku me të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do ta jap gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF në rritjen e efektivitetit të procesit dhe zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit - Prioritet i lartë**E gjetura**

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar pesë (5) pyetje kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi vërejtur se KPK ka arritur të plotësoj pyetësorin në përputhje me kërkesat e përcaktuara të MFK-së, me përjashtim të çështjeve në vijim:

- Në shumicën e komponentëve KPK është përgjigjur/vlerësuar më notën maksimale (3), mirëpo në disa raste nuk kishte dokumentacion mbështetës për të konfirmuar saktësinë e këtyre përgjigjeve;
- Për hartimin e planit vjetor dhe strategjik, KPK ka pasur një përfshirje të gjerë si: Kryesuesi i Këshillit, Drejtori i Sekretariatit, Përfaqësuesit e Prokurorive, Prokurorët, Profesionist Ligjor dhe Personeli Administrativ. Menaxheret e njësive kanë qenë të përfshirë në diskutimet e planit të strategjisë, mirëpo kosto e strategjisë nuk është në përputhje dhe e mbështetur nga KASH² (2016-2018); dhe
- KPK ka themeluar grupin për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të planit strategjik, mirëpo themelimi i tij ishte bërë më vonë, në gjysmën e tetorit të vitit 2016. Si rrjedhojë nuk është monitoruar progresi i arritjes së objektivave për vitin 2016.

Rreziku

Mungesa e informatave të plota në pyetësorin e vet-vlerësimit paraqet mungesë të informacionit për MF-në rreth funksionimit të sistemit të MFK-së. Mungesa e monitorimit të arritjes së objektivave dhe analizës në lidhje me shkaqet e dështimit të mundshëm të tyre, rezulton me dobësi në procesin buxhetor si dhe zvogëlimin e mundësisë për reagimin me kohë ndaj sfidave të ndryshme.

Rekomandimi 3

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat për të ofruar informacione të plota rreth funksionimit të sistemit të MFK-së. Pas plotësimit të pyetësorit duhet aplikuar një mekanizëm të rishikimit për të konfirmuar saktësinë e të dhënave të prezantuara si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës konform kërkesave.

² Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit KPK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Në kuadër të KPK-së operojnë shtatë (7) Prokurori Themelore, Prokuroria Speciale dhe Prokuroria e Apelit. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportim me kohë. Njësitë (programet) e KPK-së kanë strukturën e tyre organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. Ato raportojnë për aktivitetet e tyre operationale dhe performancës në KPK dhe në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet Auditimi (KA) efektiv.

NjAB operon me një (1) anëtar të stafit - Drejtori i njësisë. Kjo njësi kishte përgatitur planin vjetor të auditimit për vitin 2016 të bazuar në vlerësim të rrezikut, prioritetëve dhe fushave të cilat janë cilësuar me rrezik më të lartë. Për vitin 2016 janë planifikuar dhe realizuar pesë (5) auditime, të cilat kanë mbuluar fushat si: Procesi i donacioneve dhe aspektet financiare, Rekrutimi i stafit dhe pagat, Proceset e prokurimit, Servisimi i automjeteve dhe Proceset buxhetore e financiare.

Raportet NjAB-së ishin të një cilësie të mirë, me të gjetura dhe rekomandime të qarta, përmes të cilave menaxhmentit i është ofruar pasqyrë e qartë për funksionimin e kontrolleve të brendshme. Gjatë vitit 2016 KA kishte mbajtur katër (4) takime në të cilat janë shqyrtuar rekomandimet e NjAB-së. Megjithatë edhe përkundër kësaj niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte i ulët.

Çështja 4 - Niveli i ulët i adresimit të rekomandimeve të NjAB - Prioritet i lartë

E gjetura	Raportet e auditimit të brendshëm nuk ishin trajtuar në nivelin e duhur nga menaxhmenti. Nga 25 rekomandimet e dhëna në pesë (5) raportet e auditimit, vetëm 15 rekomandime janë zbatuar, ose 55% e tyre. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet të zbatohen me kohë.
Rreziku	Mos zbatimi i rekomandimeve të NjAB-së ka ndikim negativ në funksionimin e kontrolleve të brendshme si dhe rritë rrezikun që gabimet dhe mangësitë e njëjta të përsëriten edhe në të ardhmen.
Rekomandimi 4	Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë bashkëpunim të ngushtë me NjAB-në dhe KA-në për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti auditimit të brendshëm. Derisa KA duhet të avancojë rolin e vet në këtë proces me qëllim të mbajtjes së menaxhmentit më përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KPK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Raportimi ishte bërë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Në vitin 2016, KPK ka përdorur 96% të buxhet final, nivel i njëjtë me vitin paraprak (96%), megjithëse këtë përqindje e kanë ndikuar edhe vendimet e Qeverisë për reduktimin e fondeve në fund të vitit.

Realizimi i procedurave të prokurimit publik ishte në përputhje me rregullat e përcaktuara për prokurimin publik.

Ndërsa dobësi të theksuara janë vërejtur në shfrytëzimin e buxhetit, pagesat e shtesave për punë jashtë orarit, kompensimet e anëtarëve të këshillit dhe komisioneve, menaxhimin e personelit me ushtrues detyre, si dhe vonesat në realizimin e pagesave dhe raportimin e obligimeve të papaguara në MF. Po ashtu menaxhimi dhe raportimin i pasurisë është përcjellë me dobësi.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	8,013,619	8,253,448	7,669,086	7,034,306	6,211,154
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,773,589	7,773,388	7,669,086	7,034,306	6,211,154
Të hyrat e bartura	-	240,030	-	-	-
Të hyrat vetanake	240,030	240,030	-	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 239,829€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2016, KPK ka përdorur 96% të buxhet final ose 7,669,086€, shpenzim i njëjtë (në përqindje) krahasuar me vitin 2015. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

Mjetet e ndara në fondin e të hyrave të bartura dhe vetjake në vlerë nga 240,030€ janë rezultat i Memorandumit të Mirëkuptimit në mes Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KPK-së dhe MF-së për kompensimin e stafit mbështetës. Nga vitit 2012 e tutje me ligjin e buxhetit është ndaluar shfrytëzimi i të hyrave vetjake në bazë të memorandumëve, andaj që nga viti 2011 përsëriten në tabelat e buxhetit.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,013,619	8,253,448	7,669,086	7,034,306	6,211,154
Pagat dhe Mëditjet	6,403,437	6,114,110	5,616,146	5,169,452	4,457,648
Mallrat dhe Shërbimet	1,340,552	2,014,198	1,928,354	1,600,916	1,505,529
Shërbimet komunale	199,630	104,387	103,834	131,945	135,870
Investimet Kapitale	70,000	20,753	20,752	131,993	112,107

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Buxheti fillestar i KPK-së ka pësuar rritje në shumën prej 239,829€ ose 3%. Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- KPK ka paraqitur kursimet buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve të programit Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me vlerë prej 221,070€, këto mjete Qeveria e Kosovës i ka tërhequr në bazë të vendimit Nr.07/112 të datës 18.10.2016;
- Me vendimin Nr.12/122 të datës 23.12.2016 Qeveria e Kosovës ka paraqitur kursime me vlerë prej 309,308€ në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në programin Prokuroritë dhe administrata;
- Bazuar në ligjin Nr.05/L-109 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit Nr.05/L-071 për buxhetin e Kosovës, Qeveria ka ndarë 150,000€ shtesë për KPK në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe ka zvogëluar kategorinë e investimeve kapitale për 43,400€; dhe
- Me vendim Nr.11/120 të datës 14.12.2016 Qeveria ka ndarë 220,000€ në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për pagesën e një pjese të obligimeve ndaj avokatëve të angazhuar sipas detyrës zyrtare, ekspertëve dhe ndërmjetësueseve, njëherit ka paraqitur kursime në kategorinë e investimeve kapitale 5,846€.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollët kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e KPK-së. Në këtë kategori janë shpenzuar 5,616,146€ apo 92% të buxhetit final. Megjithatë në ekzaminimet tona identifikuaam dobësitë si në vijim:

Çështja 5 - Plotësimi i pozitës me ushtrues detyre më gjatë se tre muaj – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Ligjit të Shërbimit civil Nr.03/L-149 neni 30 pika 4, në rast se mbetet ndonjë pozitë e lirë në shërbimin civil, Ushtruesi i Detyrës (U.D) nuk mund të ushtrojë aktivitetin më gjatë se tre (3) muaj.
- Mirëpo në KPK është tejkalluar afati i përcaktuar me ligj për mbulimin e pozitave me U.D. Kjo është vërejtur në pozitën e Zyrtarit të lartë për prokurim që është nga data 11.05.2016, me tejkallim të afatit prej katër (4) muaj.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave kyçe me U.D më tepër se tre (3) muaj rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Kjo ndikon negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të ndërmerr veprime për të ndërprerë mbulimin e pozitave me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që pozita të plotësohet me kontratë të rregullte sipas përcaktimit ligjor.

Çështja 6 - Dobësi në kompensimet për kujdestari - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas vendimit nr. 119/2011 të vitit 2011 për kompensimin e Prokurorëve dhe stafit mbështetës në KPK, për punë jashtë orarit, për kujdestari, gjatë fundjavave dhe festave zyrtare, është përcaktuar/bërë kompensimi si në vijim: 10€ në ditë për Prokuror, 5€ në ditë për sekretarët juridik dhe 100€ në muaj për vozitës, pavarësisht sa orë është punuar.

Ky kompensim (vendim) nuk është në harmoni me parimet e ligjit të punës (Nr.03/L-212) që parasheh kompensimet sipas orëve të shpenzuara në punë. Po ashtu vendimi nuk është në harmoni as me Ligjin për pagat e nëpunësve civil nr.03/L-147, që parasheh se pagesa për punë jashtë orarit të llogaritet për çdo orë të plotë punë, duke i shtuar vlerën si në vijim: 30% shtesë gjatë ditëve të punës; 50% shtesë për punën gjatë fundjavës dhe 100% shtesë për punën jashtë orarit gjatë festave zyrtare.

Rreziku Pagesat për punë shtesë (kujdestari) të prokurorëve dhe stafit mbështetës në këtë mënyrë rrit rrezikun për kompensim jo të drejtë për punën e kryer. Pagesat fikse, pavarësisht orëve të punuara nuk janë vlerësime objektive dhe nuk përputhen me parimet e ligjit si dhe mund të paraqesin pagesa të parregullta.

Rekomandimi 6 Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë se vendimet për kompensime për punë jashtë orarit të jetë në harmoni me rregullat e përgjithshme dhe parimet e Ligjit të punës dhe Ligjit për pagat e nëpunësve civil, për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë edhe komunalitë) në vitin 2016 ishte 2,118,585€, prej tyre janë shpenzuar 2,032,188€, ose 96% e buxhetit. Në kuadër të këtyre shpenzimeve dominojnë; shpenzimet e përfaqësimit dhe avokaturës me 919,424€, shpenzimet e karburanteve për vetura 107,629€ dhe shpenzimet për zyre 104,432€. Testimi i kësaj kategorie ka vënë në pah çështjet në vijim:

Çështja 7 - Zotimi dhe urdhërblerja, pas pranimit të faturës - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet zotimi, pastaj të pranohet malli apo shërbimi dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.
- KPK nuk kishte respektuar rregullat e përcaktuara, përkatësisht zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhërblertes ishin bërë pas pranimit të faturës. Në gjashtë (6) raste kishte vonesa në nxjerrjen e urdhërblertes prej katër (4) deri 56 ditë, ndërsa në tri (3) raste kishte vonesa për zotim të mjeteve prej 44 deri në 46 ditë.
- Rreziku** Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë në vonesa të ekzekutimit të pagesave, si dhe në ndëshkime për vonesa të pagesave. Pranimi i faturës dhe mallrave para procesimit të urdhër blertes rrit rrezikun që të pranohen mallra dhe shërbime jashtë kërkesave të parapara, si në sasi ashtu edhe në cilësi.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë që blerjet bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet, respektivisht çdo furnizimi t'i paraprijë zotimi dhe urdhër blerja. Furnizimet dhe procesimi i pagesave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPN-në dhe më rregullat e Thesarit.

Çështja 8 - Vonesa në shlyerjen e obligimeve - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Neni 37 pika 1 e Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF - përcakton se "të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë".
- KPK nuk ka arritur të kryejë pagesat në afatin e përcaktuar ligjor. Në pesë (5) raste kemi vërejtur se kishte vonesa pas afatit ligjor prej 22 deri 158 ditë. Njëherit edhe pagesat për ekspert janë bërë me vonesa të konsiderueshme, shpenzimet për muajt: korrik, gusht, shtator, tetor dhe nëntor të vitit 2015, janë paguar me 25.02.2016, me vonesa prej 55 deri 205 ditë.
- Rreziku** Vonesat në ekzekutimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa shtesë të dëmshpërblimeve ndaj furnitorëve. Mungesa e fondeve mund të shpie edhe në dështim të pagesave dhe bartjen e obligimeve për vitin e ardhshëm.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit/pagesave me qëllim që çdo faturë të paguhet në afatin e paraparë ligjor.

Çështja 9 - Kompensimet për anëtarët këshillit prokurorial – Prioritet i lartë

- E gjetura** Ligji për të Ardhurat Personale përcakton tatimin e të ardhurave (pagave, kompensimeve etj, sipas nenit 9).
- Me vendim të këshillit prokurorial të vitit 2016, anëtarët e këshillit prokurorial kompensohen deri në 25% të pagës bruto të prokurorit të departamentit të përgjithshëm, të prokurorisë themelore. Anëtarët e këshillit prokurorial të Kosovës janë kompensuar nga kodi për shërbime intelektuale, kategoria mallra dhe shërbime. Për këto kompensime nuk janë paguar/kryer kontributet pensionale dhe tatimi në të ardhura, kjo është në kundërshtim me Ligjin për të Ardhurat Personale, i cili përcakton se çdo e hyrë duhet të tatimohet.
- Rreziku** Mos deklarimi i kontributeve dhe tatimeve në paga mund të ekspozoj organizatën/zryrtarët para ndëshkimeve nga Administrata Tatimore e Kosovës.
- Rekomandimi 9** Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë që çdo vendim dhe rregullore e brendshme të hartohet në harmoni me ligjet bazike, siç është LMFPF dhe ligji për të ardhurat personale, duke shmangur shpenzime dhe pagesa të jashtë-ligjshme.

3.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 20,753€, i cili është shpenzuar në tërësi gjatë vitit 2016. Ne kemi verifikuar nëse projektet për investime kapitale ishin të përfshira në Programin për Investime Publike dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Gjithashtu kemi rishikuar nëse gjatë vitit ka ndodhur ndonjë ndryshim lidhur me projektet e planifikuara dhe nuk kemi hasur në ndonjë çështje për tu theksuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria me vlerë mbi 1,000€ në KPK arrinë vlerën prej 3,599,409€, ndërsa pasuritë nën vlerën prej 1,000€ janë 648,398€. Çështjet e identifikuara dhe rekomandimet rreth Pasurisë në KPK, janë paraqitur në pjesën e parë të këtij raporti, pjesën e Opinionit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

Vlera e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 295,751€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016.

Ne kemi kryer teste lidhur me obligimet në fund të vitit si dhe ato të raportuara në raportet mujore. Bazuar në këtë shpalosim mangësitë si në vijim.

Çështja 10 - Raportim jo i saktë i obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullës financiare nr.02/2013MF Raportimi i obligimeve të papaguara, parasheh që çdo organizatë buxhetore të raportojë obligimet e papaguara përmes raporteve mujore. KPK ka arritë të raportojë më kohë lidhur me obligimet e papaguara, mirëpo raportet e dorëzuara nuk ishin të sakta.

Ne kemi vërejtur se disa fatura të pranuar dhe të papaguara nuk ishin përfshirë në raportet e obligimeve si: fatura në vlerë prej 7,207€ e pranuar në dhjetor 2015, fatura në vlerë 12,500€ në janar 2016, fatura në vlerë 5,095€ në shkurt 2016 si dhe fatura në vlerë 170€ në korrik 2016.

Rreziku Mos raportimi i saktë i obligimeve mujore rrit rrezikun e ekzekutimit të pagesave të dyfishta ose mos pagesës së obligimeve ndaj operatorëve dhe ekspozimit ndaj ndëshkimeve të mundshme nga furnitorët. Po ashtu krijon paqartësi rreth gjendjes së përgjithshme financiare të institucionit.

Rekomandimi 10 Kryesuesi i Këshillit Prokurorial duhet të sigurojë kontrollë shtesë sa i përket raportimit të saktë dhe me kohë të obligimeve. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		KPK ka hartuar një plan për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo niveli i zbatimit të tyre ishte shumë i ulët.	
2.4 Lista kontrolluese e vet-vlerësimit të MFK-së	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Në proces të zbatimit,	
2.5.1. Vlerësimi i rrezikut	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se kanë hartuar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, si dhe ka caktuar një person përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza mujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	Po		

2.6 Sistemi auditimit të brendshëm	Kryesuesi i KPK-së duhet të siguroj një bashkëpunim të ngushtë në mes të menaxhmentit dhe NJAB-së për të identifikuar mangësitë e kontrolleve të brendshme dhe të ndërmer veprime shtesë që rekomandimet e kësaj njësie të gjejnë zbatim në praktikë. Më tej, KA duhet të forcojë rolin e vet në këtë proces, duke e mbajtur menaxhmentin më përgjegjës për implementimin e rekomandimeve.			Janë marrë veprime por ende nuk është zbatuar
3.4 Prokurimi	Kryesuesi i KPK-së duhet të siguroj rritjen e efikasitetit në funksionimin e kontrolleve të brendshme ekzistuese në mënyrë që blerjet të bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet e mjaftueshme.			Janë marrë veprime por ende nuk është zbatuar
3.4 Prokurimi	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.			Nuk është zbatuar
3.4 Prokurimi	Kryesuesi i KPK-së në bashkëpunim me personat përgjegjës duhet të sigurojnë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.			Nuk është zbatuar
3.5.2 Kompensimet-Pagat dhe mëditjet	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se Zyrtarët Përgjegjës kanë kryer më kohë vlerësimet vjetore për të punësuarit. Në këtë mënyrë, krijohet baza për të shpërblyer të punësuarit më meritor, si dhe identifikohen fushat për përmirësim të mëtejme e cila mundëson hartimin e një programi për zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të stafit.		Në proces të zbatimit,	

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë. Regjistrimi i tyre duhet të bëhet (të përmbajnë të gjitha elementet) në përputhje me legjislacionin. Zhvlerësimi duhet të bëhet në përputhje me normat e përcaktuara, dhe në PVF të prezantohet vlera neto e pasurisë. Ndërsa në fund të çdo viti pas procesit të inventarizimit, duhet të harmonizohen regjistri i përgjithshëm i pasurisë me regjistrin e nxjerrë në procesin e inventarizimit.		Në proces të zbatimit,	
3.7.2 Trajtimi i borxheve	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se janë duke u monitoruar në vazhdimësi kontrollet, për të siguruar që prezantimi i obligimeve të papaguara të bëhet në përputhje me gjendjen ekzistuese tyre. Më tutje të sigurojnë se vlera e obligimeve të paraqitura në PVF është e harmonizuar me raportin e obligimeve të muajit në fund të vitit.			Nuk është zbatuar

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Nr. Prot. DSKPK/ 184 / 2017

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Lavdim Krasniqi

Drejtor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës,

Data: 13 qershor 2017 Prishtinë

